



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 224-332

Nr. 241/8 Prot.

Tiranë më, 21/07/2016

V E N D I M

Nr. 95, Datë 21.07.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË HAS "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", të ushtruar në Bashkinë Has, për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2015 dhe për disa çështje edhe nga viti 2010 - 2012.

II. Të miratoj Rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has për të gjithë periudhën e audituar, vitin 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë hapur librat e pagave të punonjësve, në kundërshtim me nenin 95 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenin 47 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Has.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për hapjen dhe plotësimin e librave të pagave të punonjësve të Bashkisë me të gjitha të dhënat e nevojshme, për vitin 2013, 2014 dhe 2015.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Zhvillimi i aktivitetit dhe veprimtarisë së Bashkisë Has është mbështetur në rregulloren e brendshme e cila nuk është miratuar në Këshillin Bashkiak.

-Nuk është hartuar rregullore për zbatimin e ligjit për arkivat dhe as rregullore e kodit të etikës. Titullari nuk ka ngritur një sistem deklarimi efikas prej menaxherëve kryesor dhe nuk janë përcaktuar llojet e deklaratave dhe raporteve që duhet ti dorëzohen, afatet dhe shpeshtësia e tyre.

-Nuk janë hartuar programe trajnimi për punonjësit dhe kriteret për kualifikimin dhe përvojën profesionale që duhet të plotësohet nga kandidatët gjatë procesit të rekrutimit të stafit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 20 dhe 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa dhe të hartojë rregulloren e brendshme të institucionit, në të cilën të përshkruhen në mënyrë të detajuar detyrat e secilit pozicion pune, duke përfshirë edhe Njësitë Administrative, të përcaktohet shpeshtësia e raportimit të menaxherëve kryesor të Titullari dhe lloji e raporteve. Të hartohet dhe miratohet rregullore e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat, si dhe rregullore për kodin etik. Të merren masa për hartimin e programeve të trajnimit për punonjësit.

Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Bashkiak

3. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 në Bashkinë Has, nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik (GMS), si rezultat nuk ka strategji për evidentimin dhe minimizimin e risqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit.

-Regjistri i riskut dhe gjurma e auditimit nuk është hartuar nga asnjë sektor. Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk identifikon pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nuk jep rekomandime për përmirësim të tij, si dhe nuk përmbledh gjetjet e pyetësorit të vetëvlerësimit, e cila tregon se monitorimi është kryer dobët nga Titullari. Në këtë mënyrë sistemi i kontrollit të brendshëm është ngritur dhe ka funksionuar me mangësi. Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 8, 16, 22, 23, 24 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitullin III, shtojcën 5, 7 të “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Has të hartohet regjistri i riskut dhe nga Titullari të ngrihet grupi për menaxhimin strategjik, të hartohet gjurma e auditimit për operacionet më të rëndësishme që kryhen në institucion. Titullari i institucionit në hartimin e raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të analizojë të pesë pikat e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke përcaktuar dobësitë e sistemit dhe masat për përmirësimin e tij.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 2013-2015, në Bashkinë Has me urdhër të brendshëm të Titullarit të institucionit, janë marrë në punë 14 punonjës, në pozicione pune që mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, pa u zbatuar më parë procedurat e rekrutimit, duke shkelur parimet e shanseve të barabarta, meritës dhe aftësive

profesionale, në kundërshtim me nenet 20, 22 dhe 23 të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

4.1 Rekomandimi: Në rastet e marrjes në punë të punonjësve pozicioni i punës i të cilëve mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë, të zbatojnë të gjitha procedurat e rekrutimit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013, 2014 dhe 2015 struktura e Policisë Bashkiake ka qenë e organizuar në nivel sektori dhe e përbërë nga tre punonjës të cilët janë vendosur në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit.

-Nuk është lidhur kontratë pune tre vjeçare me asnjë nga punonjësit e Policisë Bashkiake, si dhe nuk janë marrë masa për kryerjen e kualifikimeve dhe trajnimeve.

-Policia Bashkiake Has, për të gjithë periudhën 2013-2015 nuk ka vendosur asnjë gjobë, pasi për aplikimin e tyre nuk disponon dokumentacion (bllaqe me fletë gjoba).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 7, 11 dhe 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar.

-Dokumentimi i punës së përditshme të këtij sektori ka mangësi, pasi nuk është përgatitur dhe mbajtur libri i shërbimit 24 orësh, nuk janë hartuar planet e vendosjes (dislokimit) në shërbim, plani ditor i veprimeve etj.

Në aktivitetin e kësaj strukture për vitin 2013 dhe 2015 nuk ka bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse më datën 13.05.2016 nuk kanë shlyer taksat vendore 231 subjekte në vlerën **20,158,820 lekë**.

5.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Has të merren masa për trajnimin e punonjësve të Policisë Bashkiake sipas kërkesave ligjore në fuqi. Në rastet e marrjes së punonjësve të rinj në punë të zbatohet procedura e përzgjedhjes nga komisioni i posaçëm. Nga policia Bashkiake të përgatitet dhe plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për pasqyrimin e veprimtarisë së përditshme të këtij sektori.

- Nga Zyra e Taksave dhe e Policisë Bashkiake Has të merren masa që të propozojnë dhe miratojnë në Këshillin Bashkiak paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në zbatim të nenit 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

-Të përcaktohen nga Këshilli Bashkiak rastet e ndërhyrjes me forcë të Policisë Bashkiake në mbështetje të administrimit të taksave vendore dhe krahas detyrave të tjera të ngarkuara Policia Bashkiake të vihet në mbështetje të strukturave të tjera të Bashkisë për kontrollin e territorit, vjeljen e taksave vendore dhe administrimin e aseteve.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga administratori shoqëror i ish-Komunës Fajzë për vitin 2014 dhe 2015, për të vlerësuar gjendjen social-ekonomike të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nuk është kryer asnjë vizitë në këto familje, ndërsa nga administratori shoqëror i Bashkisë Has dhe ish-Komunës Golaj, kjo vizitë nga dy herë në vit, është bërë

vetëm njëherë, në kundërshtim me nenin 31, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimin shoqëror”.

-Dosjet e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nuk janë të organizuara me listë inventarizimi për dokumentacionin që përmbajnë, certifikatat e lëshuara nga gjendja civile, nuk kanë shënimet përkatëse si datën e ndarjes nga trangu familjar për familjet e reja, shënimin “banorë i vjetër” për familjet e vjetra, në kundërshtim me pikën 3 të udhëzimit të “Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta”, nr. 338/3, datë 10.03.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

6.1 Rekomandimi: Administratori shoqëror i Bashkisë Has dhe Njësive Administrative për të vlerësuar gjendjen social-ekonomike, të kryejnë dy herë në vit vizita në familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike. Të pajisen me listë inventarizimi të dokumentacionit dosjet e ndihmës ekonomike. Nga gjendja civile certifikatat që lëshohen për përfitimin e ndihmës ekonomike të pajisen me shënimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të audituara rezultuan me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me pikën 4, paragrafi 4 i udhëzimit KM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

7.1 Rekomandimi: Bashkia Has, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve në vite, gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël u paraqitën mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumenteve si:

-mungojnë kërkesat e argumentuara për përcaktimin e nevojave për blerje mallrash, në rastet e shërbimeve të punimeve të mirëmbajtjeve preventivat paraprak nuk janë shoqëruar nga skicat me përmasa dhe planvendosjet.

-për rastet e blerjes së mallrave nuk ka argumentim të fondit limit nëpërmjet testimit të tregut, mungon raporti përmbledhës të procedurës të miratuar nga Kryetari i AK apo kualifikimi final i shkarkuar nga APP

- në 6 raste nuk janë mbajtur procesverbalet e skualifikimit dhe njoftimit të OE të radhës apo shkarkimi nga sistemi elektronik i menu-së së mesazheve mbi klasifikimin e ri të procedurës,

- nuk ka urdhër për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimeve dhe mallrave në kundërshtim me Urdhrin e MF nr. 33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 37, 42,43 dhe 44.

8.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për vendosjen e rregullave për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që

nga hartimi i kërkesave e përcaktimit të nevojave, përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës deri në përfundimin e procedurës së prokurimit, mbi bazën e dokumenteve të plota autorizues, vërtetues dhe të kontabilitetit”.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Financës nuk mbahej ditar i mirëfilltë kontabël për të ardhurat, por rakordon me anë të ekstrakteve të bankës me shifrat e regjistrit sipas llojeve të ardhurave të mbajtur nga Sektori i Tatim Taksave. Pasqyrimi i të ardhurave në bilanc bëhet me artikull kontabël nga jashtë. Mos mbajtja e ditarëve kontabël të ardhurave nëpërmjet arkës dhe bankës nga Sektori i Financës, është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa që të ardhurat e arkëtuara nga Bashkia Has dhe Njësitë Administrative të regjistrohesh në ditarin e arkës, bankës dhe dokumentet e tjerë të kontabilitetit në llogarinë përkatëse sipas llojit të tyre.

-Pagesa e taksave nga bizneset të kryhet nëpërmjet bankës kundrejt faturës për arkëtim dhe ndërmjet Sektorit Financës dhe Zyrës Taksave të hartohen akt- rakordime mujore.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat Financiare të konsoliduara të Bashkisë Has ishin në proces finalizimi, për shkak se ish-Komuna Golaj ka konfirmuar në degën e Thesarit dhe dorëzuar Bilancin e veprimtarisë së 6-mujorit të parë 2015 me datë 27 janar 2016. Ky Bilanc paraqitet me pasaktësi të gjendjeve të llogarive sintetike dhe analitike në aktivin dhe pasivin e Bilancit të klasës 4 “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Detyrime afatshkurtër”. Kështu Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktivin e bilancit dhe gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasivin e bilancit është në të njëjtën vlerë prej 8,662,596 lekë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” pika 3 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”.

10.1 Rekomandimi: Bashkia Has dhe Njësia Administrative Golaj në bashkëpunim me Sektorin e Financës të bëjë ndarjen e debitorëve nga detyrimeve ndaj të tretëve, duke bërë sistemimet kontabël të nevojshme në bilancin e vitit të ardhshëm. Të bëhet grupimi i debitorëve sipas llojit, klasifikimin i detyrimeve ndaj të tretëve, duke i mbështetur me dokumente vërtetues. Në rast se nuk gjendet dokumentacion që mbështet këto detyrime të nxirret përgjegjësia dhe të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak për njohjen ose jo të këtyre detyrimeve.

Deri me 31.12.2016

11. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Fajza për vitin 2015 nuk ka urdhër nga Titullari për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Janë hartuar fletë-inventarizimi për efekt bilanci vetëm me gjendjen kontabël, në të cilën është shtuar rubrika pakësim në vlerën totale prej 1,101,707 lekë me artikujt e që i përkasin llogarive 214 “Instalime, pajisje, vegla etj” në shumën 928.475 lekë.

-llogaria 218 “Inventar ekonomik” në shumën 103,232 lekë dhe llogaria 32 “Objekte inventari” në shumën 70,000 lekë dhe është firmosur nga komisioni. Vlera prej 1,101,707 lekë ka përfshirë dhe vlerën prej 883,200 lekë të vjedhur në shkollën 9-vjeçare Vranisht me datë 04.05.2015, të ish-Komunës Fajza me datë 05.06.2013, dhe të Shkollës 9-vjeçare Fajza me datë 28.01.2013 të konfirmuar me shkresën nr. 1862/1prot datë 18.12.2015 të Drejtorisë Vendore e Policisë Kukës, Komisariati Policisë Has e cila prononcohet se për këto tre raste ka filluar procedim penal përkatës.

- Në vlerën e vjedhur prej 883,200 lekë, padrejtësisht është përjashtuar vjedhja e inventarit ekonomik të Zyrës së Gjendjes Civile të ish-Komunës Fajza në shumën 413,090 lekë, ku gjendje inventari kontabël është vetëm kompjuteri në vlerën 258,090 lekë dhe jo vlera e printerit prej 95,000 lekë dhe vlera baterisë inventar prej 60,000 lekë.

Vlera prej 1,101,707 lekë është zbritur nga bilanci përmbyllës i aktivitetit financiar të ish-Komunës Fajza të 6-mujorit të parë të vitit 2015 sipas llogarive të aktiveve të prekura nga pakësimet. Për këtë zbritje nga bilanci financiar mungon procedura e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi, e ndryshimit të destinacionit apo asgjësimit e miratimit me VKK për përfshirjen e aktiveve të humbura në pakësime dhe zbritjen nga kontabiliteti të tyre pa patur një vendim të Prokurorisë për çështjen e vjedhjes. Veprimet e mësipërme përbëjnë shkelje të nenit 11 pika 4 dhe nenit 12 pika 3/dh, e, ë, f të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Kreu IV pikat 73-119 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”.

11.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa që në realizimin e procesit kompleks të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë dhe aktiveve të trashëguara nga Njësitë Administrative të bëjë verifikimin fizik të tyre me atë kontabël, të nxjerrë diferencat dhe përgjegjësitë për to, të bëjë sistemimet e nevojshme kontabël.

- Për rastin e zbritjes nga ish-Komuna Fajza të vlerës së aktiveve prej 1,101,707 lekë nga Bilanci i vitit 2015 në mënyrë të jashtëligjshme të bëhet sistemimi kontabël në bilancin e vitit të ardhshëm në debi të aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara në kredi të Fondeve Bazë.

-Për vlerën prej 883.200 lekë të aktiveve të vjedhura të nxjerra jashtë përdorimit si dhe vlerës prej 258.090 lekë gjendje në llogarinë 214 “Instalime, pajisje, vegla etj” si dhe vlerës 155,000 lekë të pa paraqitur në inventar e cila i përket vjedhjes në Zyrën e Gjendjes Civile, të kërkohet nga Prokuroria ecuria e procedimit penal dhe vendimi për këtë çështje për të kryer veprimet e nevojshme kontabël në lidhje me vlerat e këtyre aktiveve.

-Për vlerën prej 218,507 lekë të aktiveve të pakësuar si dhe mungesa në inventar të kërkohen këto inventarë dhe të nxirren përgjegjësitë për personat që i kanë patur këto aktive në ngarkim.

Deri me 31.12.2016

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has nuk ka iniciuar procesin e hartimit dhe miratimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit (Plani i Përgjithshëm Vendor) , duke mos vepruar e përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në nenin 20 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.

12.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa dhe të filloj procesin e hartimit dhe miratimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit (*Plani i Përgjithshëm Vendor*), duke përbushur detyrimet ligjore të përcaktuara nga neni 20 i ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Has nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Has, në zbatim të kritereve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

13.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Has, në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Brenda muajit Dhjetor 2016

14. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet që administrojnë Bashkia nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Has. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

14.1 Rekomandimi: Bashkia Has, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr 946, datë 02.09.2009 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Has në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trualli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

Brenda muajit Dhjetor 2016

15. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në tre raste të dhënies me qira të aseteve publike administrohet vetëm kontrata e lidhur mes kryetarit të Bashkisë dhe të tretëve, dhe nuk administrohet asnjë dokument tjetër mbi procedurën e ndjekur nga NJQV dhe dokumentacionin e qiramarrësit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 dhe Kreun II pikat 1/a, b, ç, d, dh, pika 5, 6, 7 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiletozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

15.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa në rrugë administrative dhe ligjore për anulimin e 2 kontratave të qirasë të lidhura në kundërshtim me kriteret dhe detyrimet e përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës

dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për administrimin e pronave të ish-Komunave Golaj, Fajzë dhe Gjinaj u konstatua se nuk kanë filluar procedurat sa përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit të njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, duke tejkaluar afatet e përcaktuar në nenin 17 të ligjit duke penguar Këshillin e Ministrave të miratoj listën përfundimtare të pronave të paluajtshme që do të kalojnë në pronësi të Bashkisë, duke sjell mos përmbushjen e procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

16.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të inicioj procedurat për transferimin e pasurive të paluajtshme të ndodhura në territorin e Njësive Administrative që janë në përbërje të saj në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga Njësitë Administrative (ish-komuna) Golaj, Fajzë dhe Gjinaj, nuk janë ndërmarrë hapat ligjor për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave të kaluara në pronësi me VKM përkatëse në ZVRPP Has, në zbatim të kriteve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

17.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pyjeve e kullotave, kontabilizimin dhe krijimin e regjistrit për këto pasuri në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nga Bashkia Has, nuk është parashikuar dhe ngritura struktura e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV, ish-INVUV) pranë Bashkisë dhe nuk i ka deleguar me shkresë zyrtare përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara Këshillit të Qarkut Kukës, duke vepruar në kundërshtim me detyrimet ligjore të përcaktuara në nenet; 4, 5, 6 dhe 18.1 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

18.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), në përmbushje të në neneve 6 dhe 18.1 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet dërguar me shkresën e KLSH^{së}, nr. 327, datë 24.05.2013 dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

19.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Has, të merren masa për zbatimin e rekomandimeve dërguar nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Ujësjiellës sh.a nuk është caktuar si agjent tatimor, për arkëtimin dhe mbledhjen e disa taksave dhe tarifave nga popullata, së bashku me faturat e ujit të pijshëm, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 5 shkronja (i) të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

20.1 Rekomandimi: Bashkia Has, të marrë masa që për mbledhjen e arkëtimin e taksave dhe tarifave nga popullata, të caktojë si agjent tatimor Ujësjiellësin Has dhe për realizimin e saj të përgatitet aktmarrëveshja e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, si dhe të kryejë rakordimet periodike mujore/tremujore/vjetore.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga ana e shoqërisë “Fabrika e Pasurimit Kromit Perollaj, është ndërtuar një rezervuar për larjen e mineralit të kromit dhe një rrugë kalimi për në objekt, pa u pa paguar tarifën e qirasë së sipërfaqes ku kalon rruga.

21.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa duke ngritur një grup pune me specialist të fushës nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Administrimit të Aseteve, për përcaktimin e kapacitetit ujëmbajtës dhe sipërfaqes që zë rruga e kalimit, duke bërë përlllogaritjet për periudhën që nga koha e vënies në punë e në vazhdim të Fabrikës së Pasurimit Kromit Perollaj, duke lidhur edhe kontratë për këtë sipërfaqe sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has, u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullësor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”.

22.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashkinë Has, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullësor.

Brenda muajit Shtator 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 21,592,281 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion dhe asfaltim rruga fshatit Vlahen”, ish-Komuna Golaj, Has, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **4,962,300 lekë pa tvsh**. Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën e lidhur ndërmjet palëve nr. 724 prot., datë 13.06.2013.

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Has të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,962,300 lekë pa tvsh** nga BOE “[REDACTED]” sh.p.k dhe “[REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 724 prot., datë 13.06.2013 me objekt: “Rikonstruksion dhe asfaltim rruga fshatit Vlahen”, ish-Komuna Golaj, Has, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has ka në pronësi Tregun agro-ushqimor i cili është ndërtuar në vitin 2008 sipas kontratës datë 23.02.2008 me një vlerë prej 49,923,789 lekë i cili është marrë në dorëzim më datën 23.12.2010. Nga auditimi që u krye në lidhje me pagesën e qerasë përcaktuar për secilin person rezulton se nga 63 qytetarë që duhej të paguanin vlerën prej 5,718,367 lekë kanë paguar vlerën 3,165,367 lekë, duke mbetur debitor pa u paguar më datën 10.05.2015 edhe vlera **prej 2,453,212 lekë**, (669,840 lekë për vitin 2015) nga të cilët vazhdojnë aktivitetin 43 persona në vlerën 1,714,354 lekë ndërsa nuk vazhdojnë aktivitetin 11 persona në vlerën 423,523 lekë.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has të lidhë kontratat me gjithë personat të cilët ushtrojnë aktivitet dhe disponojnë ambiente në Tregun e qytetit (Markata) ndërkohë të kryhen njoftimet për pagesën e qerasë së papaguar nga 63 qytetarë në **vlerën prej 2,453,212 lekë**, nga të cilat vlera 669.840 lekë për vitin 2015, në të kundërtën të prishen kontratat për periudhën në vazhdim.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Fajza janë bërë pagesa OE “[REDACTED]” Person Fizik në 3 raste në shumën 2,412,000 lekë për shërbim për hapjen e rrugëve të Komunës nga bora mbi bazën e një dokumentacioni të parregullt dhe çmimeve jo sipas VKM nr. 654 datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e përkohshëm nga organe

shtetërore në situata emergjente të çdo mjetei privat” në kundërshtim me pikat 35/b dhe 36 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011”, ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” duke shkaktuar dëmin ekonomik në shumën **1,366,014 lekë**.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **1,366,014 lekë** nga Personi Fizik “XXXXXXXXXX”, sa përfituar padrejtësisht për punë të pa dokumentuar dhe në kundërshtim me çmimet zyrtare të miratuara.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Golaj me Vendimin e KRRT nr. 01, datë 11.10.2010 ka vendosur “Për miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimit”, sipërfaqe sheshit 4,950 m², sipërfaqja e ndërtimit 2126 m² numri kateve 2, ndërsa sipërfaqja prej 2774 m² për vend depozitimi koncentrate kromi etj.... Për sipërfaqen pyjore prej 4950 m², për të cilën është dhënë lejë ndërtimi me vendim të KRRT Golaj, nr. 02, datë 15.11.2010, nuk është lidhur kontratë për shfrytëzimin e kësaj sipërfaqe, në kundërshtim VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” i ndryshuar.

Shoqëria “Fabrika e Pasurimit të Kromit Perollaj” për periudhën 2011 deri 31.12.2015, nuk ka paguar tarifën për sipërfaqen e tokës pyjore të shfrytëzuar prej 4950m², duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e ish-Komunës Golaj në vlerën **440,000 lekë**.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Has, pavarësisht se nga ish-Komuna Golaj, nuk ishte lidhur kontratë, me shoqërinë “Fabrika e Pasurimit të Kromit Perollaj”, bazuar në tarifën e përcaktuara në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” i ndryshuar, të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga Shoqëria e “Fabrikës Pasurimit Kromit Perollaj” të shumës prej **440,000 lekë** dhe në të ardhmen të lidhë kontratë për objektet dhe nën **objektet si më poshtë:**

- Arkëtimin e vlerës **247,500** për sipërfaqen prej 4950 m², sipërfaqe që shfrytëzohet efektivisht nga shoqëria për shesh depozitimi minerali, bazuar në Lidhjen nr. 14, pika 2, - Për vendosje kaminash për prodhim qymyr druri dhe eshkës së kovaçit, furrë gëlqere, sheshe për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika tranzit) tokë inproduktive me afat leje përdorim 6-10 vjet, me tarifën 100.000 lekë/ha/vit.

- Arkëtimin e vlerës **192,500 lekë**, për sipërfaqen 1.1 km, për shfrytëzimin e rrugës, bazuar në pika 3 Lidhjen nr. 12, ku përcaktohet se për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rjetin ekzistues tarifa është 35,000 lekë/km/vit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 në Bashkinë Has, ish-Komunën Gjinaj dhe ish-Komunën Fajzë janë kryer pagesa për shpërblim të 29 këshilltarëve të Këshillit Bashkiak dhe Komunal për muaj në të cilët nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje të këshillit, duke u shpërblyer për punë të pakryer, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, duke sjellë përfitim padrejtësisht në total të vlerës **938,628 lekë**, respektivisht në Bashkinë Has 12 këshilltarë në vlerën 471,528 lekë, në ish-Komunën

Fajzë 6 këshilltarë në vlerën 49,320 lekë dhe në ish- Komunën Gjinaj 11 këshilltarë në vlerën 417,780 lekë.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **938,628 lekë** nga ish-këshilltarët e Këshillit Bashkiak Has dhe ish-Komunave Fajzë dhe Gjinaj sipas listës së lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në pesë raste, për katër punonjës të ish-Komunës Fajzë, janë kompensuar me pagesë pushimet vjetore të pakryera (leja e zakonshme), në kundërshtim me VKM 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” me pasojë **dëm ekonomik** për buxhetin e ish komunës në vlerën **205,483 lekë**.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **205,483 lekë**, ndaj:

1. z. B.Sh. me detyrë ish Kryetar i Komunës vlera **94,948 lekë**;
2. z. B.B. me detyrë ish Përgjegjës i Financës vlera **37,440 lekë**;
3. z. A.C. me detyrë ish Përgjegjës i Financës vlera **36,140 lekë**;
4. z. D.Ç. me detyrë ish Inspektor i Taksave vlera **36,955 lekë**.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën janar 2013 - qershor 2015, është kryer kompensim për shpenzime të impulseve të telefonisë celulare në vlerën 5,000 lekë/muaj, (gjithsej 30 muaj), në favor të z. B.Sh. me detyrë ish Kryetar i Komunës Fajzë, në vlerën **150,000 lekë**, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë” të ndryshuar.

7.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **150,000 lekë** nga ish Kryetari i Komunës Fajzë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Për muajin shtator 2013, dy punonjësve të ish-Komunës Fajzë përveç pagës mujore u është dhënë edhe 1 pagë paradhënie, duke mos u kryer ndalesa në periudhën në vazhdim, me pasojë **dëm ekonomik** për buxhetin e ish-Komunës Fajzë në vlerën totale **75,333 lekë**, përfituar padrejtësisht nga z. B.Sh. me detyrë ish Kryetar i Komunës vlera 42,552 lekë dhe z. B.B. ish përgjegjësi i financës vlera 32,781 lekë.

8.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **75,333 lekë**, respektivisht ndaj z. B.Sh. vlera 42,552 lekë dhe z. B.B. vlerën 32,781 lekë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has, për periudhën janar-mars 2013, në tre raste llogaritja e pagës së punonjësve është bërë në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” i ndryshuar, duke përfituar padrejtësisht 3 punonjës në total vlerën **41,953 lekë**.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **41,953 lekë**, ndaj:

1. Z. Y.Li. **9,172 lekë**;
2. Z. H.Sh. **25,689 lekë**;

3. Z. I.M. 7,092 lekë.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has, janë kryer pagesa për punëtorë me kohë të pjesshme për shërbime mirëmbajtje rrugësh sipas preventivave të kryerjes së punimeve dhe vlerës së tyre në 14 raste në shumën 898,879 lekë. Për të ardhurat e përfituara nga këta punonjës nuk është kryer ndalesa e tatimit në burim, në kundërshtim me nenet 11 dhe 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, **me pasojë dëm ekonomik në shumën 109,838 lekë.**

10.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin dhe derdhjen në Organet Tatimore të shumës **109,838 lekë** të përfutuar padrejtësisht nga punëtorët me kontratë të përkohshme, sipas shumave përkatëse.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Fajza janë kryer shpenzime për udhëtim e dieta për 7 punonjës të administratës, në mungesë të dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, si urdhër-shërbimit me përshkrimin e qëllimit të shërbimit, datat e lëvizjes dhe kostot e përlllogaritura, faturave të hotelit, autorizimit të Titullarit, në kundërshtim me pikën 3/1 germa (b) dhe (c) të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës" i ndryshuar, me pasojë **dëm ekonomik në shumën 232,000 lekë.**

11.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **prej 232,000 lekë** të përfutuar padrejtësisht nga 7 personat e mëposhtëm:

1. z. B.B. në shumën **23,000 lekë;**
2. z. H.F. në shumën **6,000 lekë;**
3. z. S.B. në shumën **6,000 lekë;**
4. z. D.Q. në shumën **86,000 lekë;**
5. z. A.M. në shumën **12,000 lekë;**
6. z. A.C. në shumën **86,000 lekë;**
7. z. N.Sh. në shumën **12,000 lekë.**

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Fajza janë kryer shpenzime për situacionet pjesore dhe atë përfundimtar të punimeve me objekt: "Rikonstruksion dhe shtesë për Shkollën 9-vjeçare Vranisht, Fajza-Has", në të cilën ka zëra shpenzimesh që janë pajisje e materiale ndihmëse të blera nga operatori ekonomik fitues sipërmarrës i punimeve "██████" shpk, të cilave nuk ju është zbritur vlera 20% e tvsh, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" **me pasojë dëm ekonomik në shumën 770,320 lekë.**

12.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **prej 770,320 lekë** nga Shoqëria "██████" sh.p.k, përfutuar padrejtësisht nga përlllogaritja dy herë e tvsh mbi zërat e situacionuar për makineri e

pajisje, të cilat duhet të zbriteshin nga shuma e shpenzimeve të situacionit para se të aplikohet tvsh.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Fajza janë kryer pagesa në vitin 2015 në 2 raste në shumën 546,000 lekë për blerje karburant në vlerën 448,000 lekë dhe blerje materiale mirëmbajtje e pastrimi në vlerën 98,000 lekë, mallra të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinë, pasi nuk është prerë fletë-hyrje e për rrjedhojë nuk është prerë dhe fletë dalje, duke mos lënë asnjë gjurmë për lëvizjen e këtyre mallrave (aktiveve), në kundërshtim me pikat 35-43 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, *me pasojë dëm ekonomik në shumën 546,000 lekë.*

13.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **546,000 lekë** nga z. A.C. ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe në cilësinë e ish-nëpunësit zbatues që ka kryer pagesën për blerjen e mallit dhe kontabilizimin në mungesë të dokumentacionit të magazinës.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Gjinaj në vitin 2013 dhe 2014 në bazë të urdhrave të Titullarit të Institucionit nr. 3 datë 01.02.2013, nr. 4 datë 01.11.2013, nr. 2 datë 01.06.2014 “Për pajisjen me numër telefoni celular të Kryetarit të Komunës” janë kryer blerje kartash telefoni për përballimin e shpenzimeve të telefonisë celulare të ish-kryetarit të Komunës Gjinaj, në kundërshtim me pikat 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” *me pasojë dëm ekonomik në vlerën 150.000 lekë.*

14.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **150,000 lekë**, të përfituar padrejtësisht nga z. P.Th. në funksionin e ish-Kryetarit të ish-Komunës Gjinaj.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Gjinaj janë kryer pagesa për punëtorë me kohë të pjesshme për mirëmbajtje rruge sipas situacioneve të punëve të kryera në 32 raste në shumën 1,680,000 lekë. Për të ardhurat e përfituara nga këta individë nuk është bërë ndalesa e tatimit në burim në kundërshtim me nenet 11 dhe 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" të ndryshuar, *me pasojë dëmin ekonomik në shumën 189,250 lekë.*

15.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin dhe derdhjen në Organet Tatimore të shumës **189,250 lekë**, të përfituar padrejtësisht sipas shumave përkatëse të ndalesës për tatimin e të ardhurave nga personat e paguar sipas tabelës.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura rezultoi se për vitet 2013-2015, nuk kanë paguar ujin e pijshëm 139 persona në vlerën **prej 736,200 lekë**, respektivisht:

-Për ujësjellësin Nikoliq 47 persona në vlerën 338,400 lekë;

-Për ujësjellësin Golaj 92 persona në vlerën 397,800 lekë.

-Lista me personat debitorë të cilët nuk kanë paguar tarifën e ujit të pijshëm paraqiten bashkëlidhur procesverbalit nr. 3 datë 12.05.2016 hartuar për taksat vendore.

16.1 Rekomandimi: Bashkia Has dhe administratori i Njësisë Administrative Golaj të marrin masa për njoftimin dhe arkëtimin nga 139 persona të cilët nuk kanë paguar vlerën e ujit të pijshëm prej **736,200 lekë**, në të kundërtën të kryhet ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi:

- Nga vlera e 194 debitorëve të cilat ishin regjistruar në kontabilitet, më datën 31.12.2015 prej **12,415,000 lekë**, 86 subjekte janë aktiv dhe nuk kanë paguar vlerën e taksave prej 5,821,100 lekë, ndërsa 108 subjekte në vlerën 6,495,160 lekë, nuk janë aktiv, pasi i kanë mbyllur aktivitetin apo janë larguar nga rrethi Hasit.

Nuk ishin regjistruar në kontabilitet 38 debitorët e taksave në shumën **4,495,076 lekë**, respektivisht:

- 23 subjekte të cilat janë pajisur me lejë minerare, për periudhën objekt auditimi nuk kanë paguar taksat vendore në ish-Komunën Golaj në vlerën **4,375,216 lekë** nga e cila për periudhën 2013-2015 - 17 subjekte në vlerën 2,985,045 lekë dhe periudhën 2011-2012 – 6 subjekte në vlerën 1,417,168 lekë

- Nga të dhënat e paraqitura nga ish-komuna Golaj, rezulton se edhe pse 15 subjektet kanë vetdeklaruar biznesin e tyre privat ambulant dhe janë njoftuar me shkrim për shumën që janë debitor të nënshkruar edhe prej tyre në ish-komunën Golaj për vitin 2013-2014, por ende nuk kanë paguar taksat në vlerën prej **119,860 lekë**, respektivisht nga viti 2013 për vlerën 55,560 lekë dhe vitin 2016 për vlerën 64,300 lekë.

17.1 Rekomandimi: Nga Zyra e Taksave të Bashkis Has të merren masa në zbatim të nenit 70 pika 3 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar të hartohen dhe dërgohen zyrtarisht njoftim vlerësimet tatimore për 232 subjekte dhe për arkëtimin e shumës **16,910,076 lekë**, nga të cilat 194 subjekte në shumën 12,415,000 lekë janë kontabilizuar, ndërsa 38 subjekte në vlerën **4,495,076 lekë** të kontabilizohen si debitorë dhe për arkëtimin e vlerës totale të debitorëve prej 16,910,076 lekë, të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar.

b.Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar.

c.Zyra e Taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.Sh”, i ndryshuar me ligjin nr.164/2014 datë 15.12.2014.

d. Nga Zyra e Taksave të Bashkisë Has, të listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës bujqësore nga fermerët, taksa e popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen tatimpaguesit familjarë** (të Bashkisë Has dhe 3 njësitë Administrative), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave, tarifafat etj.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Zahrisht, Faza II-të”, ish-Bashkia Krumë, Has, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në vlerën **579,000 lekë pa tvsh, për punime të pakryera në fakt.** Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën nr. 593 prot., datë 23.09.2014 të lidhur ndërmjet palëve.

18.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **579,000 lekë** pa tvsh nga OE “XXXXXXXXXX” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 593, prot., datë 23.09.2014 me objekt “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Zahrisht, Faza II-të”, ish-Bashkia Krumë, Has, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Sistemim asfaltim i segmentit rrugor Komisariat-Ujësjellës, Krumë”, Bashkia Has, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **996,500 lekë** pa tvsh . Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën nr. 530, prot., datë 13.06.2013 të lidhur ndërmjet palëve.

19.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **996,500 lekë** pa tvsh nga OE “XXXXXXXXXX” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 530 prot., datë 13.06.2013 me objekt “Sistemim Asfaltim i segmentit rrugor Komisariat-Ujësjellës, Krumë”, Bashkia Has, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim i Shkollës 9-Vjeçare Helshan”, ish-Komuna Golaj, Has, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën* **1,420,131 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 957,031 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 463,100 lekë, si pasojë e përfshirjes në situacionin përfundimtar të tvsh-së për**

pajisjet. Mos kryerja e punimeve është në kundërshtim me preventivin e paraqitur në tender dhe kontratën e lidhur ndërmjet palëve nr. 600 prot., datë 05.11.2012.

20.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **1,420,131 lekë pa tvsh** nga OE “XXXXXXXXXX” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 600 prot., datë 05.11.2012 me objekt “Ndërtim i Shkollës 9-Vjeçare Helshan”, ish-Komuna Golaj, Has, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Anëtarët e KVO së ish-Komunës Golaj, në prokurimin publik me objekt “Sistem i ujerave të zeza për lagjet Kamber, Çunaj, Bardhosh fshati Letaj”, kanë skualifikuar padrejtësisht OE, të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim, në kundërshtim me nenet 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore në vlerën **495,223 lekë**.

21.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Has të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **495,223 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit në ngarkim të z. Z.B. zj. R.K. dhe z. A.D. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Brenda vitit 2016

22. Gjetje nga auditimi: Nuk është përmbushur detyrimi kontraktual për periudhën 2013-2015 nga qiramarrësi M.C. për kontratën e lidhur 01.01.2013, duke mos kryer pagesën e qirasë mujore në vlerën **92,000 lekë**.

22.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për arkëtimin e detyrimit ekonomik në vlerën **92,000 lekë** për subjektin “M.C.” në zbatim të Kreut III të VKM nr. 54, datë 25.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga Ish-Komuna Fajza me urdhër-shpenzimin nr.53, datë 17.05.2013 është bërë pagesë në vlerën **150,000 lekë** operatorit ekonomik PF “A.M.” për shërbimin e mirëmbajtjes “Rrethim e konstruksion varreza fshati Fajza” në mungesë të procedurës së prokurimit dhe faturës së furnitorit në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9/pika4/ë, neni 11/pika 4 dhe neni 12/ pika3/dh,e,f, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 150,000 lekë**.

23.1 Rekomandim: Bashkia Has të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **150,000 lekë** nga z. B.B. ish-Përgjegjësi i Zyrës së Financës në cilësinë e nëpunësi zbatues që ka kryer pagesën e shërbimit dhe ka kontabilizuar këtë veprim ekonomik në mungesë të dokumentacionit autorizues, vërtetues dhe mbështetës.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil:

Mbështetur në nenin 58 shkronja “b” e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, datë 30.05.2013 i ndryshuar, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, *të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, nga masa disiplinore - Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, e parashikuar në nenin 58, germa “b” deri në masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit”, për:*

1. Z. I.M. me detyrë Përgjegjësi i Zyrës së Taksave

-Për mos rakordimin dhe mos arkëtimin e qirave që duhet të paguanin 63 qytetarët në vlerën **2,282,787 lekë** të cilat kanë lidhur kontratë qiraje për një periudhë 5 vjeçare fund vitit 2010 deri 31.12.2015.

-Nuk ka marrë masat e nevojshme ligjore për vjeljen e debitorëve të taksave vendore, për pasojë 194 subjekte të cilat edhe pse janë regjistruar në kontabilitet më vite, më datën 13.05.2016 janë debitorë në vlerën **12,415,000 lekë**, nga të cilët, 86 subjekte janë aktivë dhe nuk kanë paguar vlerën e taksave prej 5,821,100 lekë, ndërsa 108 subjekte në vlerën 6,495,160 lekë, nuk janë aktivë, pasi i kanë mbyllur aktivitetin apo janë larguar nga rrethi i Hasit.

C/2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 9 shkronja (b), **i rekomandojmë** kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore“ **për 9 punonjësit si më poshtë:**

I. Mase disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”

1. Z. N.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Urbanistik (për periudhën 19.05.2014-vazhdim), pasi:

-Në cilësinë e anëtarit të KVO nuk është bërë skualifikimi i OE “[REDACTED]” shpk, i cili nuk plotëson kriteret e kualifikimit sipas DST në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”.

2. Z. B.B. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues (për periudhën 01.01.2013-18.02.2015), aktualisht specialist finance në Njësinë Administrative Fajza, pasi:

-Ka lejuar që për dy punonjës të merret dy herë paga e muajit shtator 2013, veprim i cili ka shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **75,333 lekë** për buxhetin e ish Komunës Fajzë.

-Në dy raste ka kryer kompensimin me pagesë të pushimeve vjetore të pakryera të vitit 2013 për zotin B.Sh. dhe z. B.B. në vlerën totale **86,040 lekë, me pasojë dëm ekonomik në** për buxhetin e ish Komunës Fajzë, duke vepruar në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 463, datë 16. 06. 2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002, për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar.

-Në një rast për të gjithë periudhën janar 2013-janar 2015 ka kryer pagesa për të mbuluar shpenzimet e impulseve të telefonisë celulare të kryera nga z. B. Sh me detyrë ish Kryetar i Komunës Fajzë, në kundërshtim me pikat 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë”, të ndryshuar, duke shkaktuar një **dëm ekonomik** për buxhetin e ish Komunës Fajzë në vlerën **125,000 lekë**.

3. Z. M.K. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit Urbanistik, në cilësinë e anëtarit të KPVV dhe të NJHDT, aktualisht Administrator i Njësisë Fajza dhe

4.z. A.Xh. me detyrë Përgjegjës i Zyrës Gjendjes Civile në cilësinë e anëtarit të komisionit të monitorimit të shërbimit të pastrimit të rrugëve nga dëborë.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nga mos kontrolli kanë lejuar që kryerja e shërbimit me borë pastruese për periudhën 31.12.2014-04.01.2015 dhe 04.3.2015-5.03.2015 dhe të paguar me urdhër shpenzimit nr.34, datë 3.4.2015 në shumën 504,000 lekë dhe nr.35, datë 3.4.2015 në shumën 196,000 lekë.

- Në procesverbale është bërë përshkrimi i orëve të punuara dhe rrugëve që janë pastruar nga bora me gjatësi në km, por nuk janë përcaktuar numri i orëve që ka punuar fadroma dhe traktori.

– Ka lejuar dhe paguar që për gjatësi rrugësh më të vogla janë harxhuar orë pune njësoj me gjatësi rrugësh sa dyfishi i tyre, duke kryer një mbishpenzim në shumën prej 245,518 lekë në kundërshtim me VKM nr. 654 datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e përkohshëm nga organe shtetërore në situata emergjente të çdo mjeti privat” në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011”, pika 35/b, 36.

5.zj. R.K. me detyrë specialiste e Financës në ish-Komunën Golaj, në cilësinë e hartuesit të Pasqyrave Financiare, aktualisht specialiste e Financës në njësinë Administrative Golaj.

-Për dorëzimin me vonesë në Degën e Thesarit të Pasqyrave Financiare e Bilancin e veprimtarisë së 6-mujorit të parë 2015 në 27 janar 2016.

-Bilanci paraqitet me pasaktësi të gjendjeve të llogarive sintetike dhe analitike në aktivin e pasivin e bilancit të klasës 4 “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Detyrime

afatshkurtër”, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” me 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” pika 3 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

6. z. F.C. me detyrë përgjegjës i policisë bashkiake

7. z. K.P. me detyrë inspektor i policisë bashkiake

8. z. A.D. me detyrë inspektor i policisë bashkiake

Për shkeljet e mëposhtme:

-nuk kanë hartuar planet e vendosjes në shërbim, në kundërshtim me lidhjen nr.1 të rregullores së brendshme “Tip” të Policisë Bashkiake.

-nuk është përgatitur dhe mbajtur libri i shërbimit 24 orësh, në kundërshtim me lidhjen nr.2 të rregullores së brendshme “Tip” të Policisë Bashkiake.

-nuk është hartuar plani ditor i veprimit, në kundërshtim me lidhjen nr.3 të rregullores së brendshme “Tip” të Policisë Bashkiake.

-nuk është zbatuar plani i punës mujor, pasi nuk ka dokumente që të vërtetojnë se janë marrë masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, evidentimin dhe raportimin e ndërtimeve të paligjshme, kryerjen e inspektime për respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjediset publike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr.8224, datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të Bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar.

9. z. H.K. ish-inspektor i taksave për lejet minerare për ish-Komunën Golaj, ka qenë në dijeni të mos pagimit të taksave, ku për periudhën 2010-2015 nga 24 subjekte në vlerën 9,409,460 lekë të parashikuara janë grumbulluar nga 10 subjekte në vlerën 1.786,012 lekë ose 18 %, duke mos u arkëtuar deri më datën 31.12.2015 vlera e taksave **prej 4,375,216 lekë**, ndërkohë nuk ka dërguar në fund të vitit listat e debitorëve në zyrën e financës ish-Komuna Golaj dhe nuk ka kërkuar që të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore për arkëtimin e tyre.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D/1-Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 45, 46 dhe 47 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 1 dhe 2, datë 20.04.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Bazuar në shkronjën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, që në zbatim të neneve 13 dhe 72 të

ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **7 anëtarët** e Komisionit Vlerësimit të Ofertave, **si më poshtë:**

-Katër anëtarëve të Komisioni Vlerësimit të Ofertave, respektivisht:

1. z. F.Th. Nën/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së.

2. z. H.M. Përgjegjës i Sektorit të MTS-së, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

3. z. O.M. ish-Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, aktualisht larguar nga puna.

4. z. N.B. Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO

Për shkeljet e procedurave në 7 tendera si më poshtë:

I. Për prokurimin publik me objekt “Rikonstruksioni i mbulesës çatisë Shkolla Mesme”, kontrata nr. 366/1, datë 19.06.2013 me vlerë 5,238,965 lekë, pa tvsh është konstatuar një vlerësim fiktiv nga ana e KVO-së, e cila ka vlerësuar vetëm mbi kriterin e ofertës më të ulët. Kualifikimi i OE “” dhe OE “” nga KVO është në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit, pasi këta OE nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga AK. KVO duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ka vepruar në kundërshtim me nenet 46, 53 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KVO duhet të kishte skualifikuar OE “” dhe OE “” dhe ti kishte kërkuar AK anulimin dhe përsëritjen e procedurës së prokurimit në zbatim të neneve 24/ç, 47 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. Për prokurimin publik me objekt “Sistemim Asfaltim i segmentit rrugor Komisariat-Ujësjellës”, kontrata nr. 530/1, datë 13.08.2014 me vlerë 16,290,650 lekë, pa tvsh dhe

III. Për prokurimin publik me objekt “Rikonstruksion shkollës Zahrisht, faza II” kontrata nr. 593/1, datë 23.09.2014 me vlerë 11,891,896 lekë, pa tvsh është konstatuar se kualifikimi i OE “” nga KVO është në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit, pasi ky OE nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK.

KVO duke kualifikuar ofertues i cili nuk plotëson kriteret për kualifikim ka vepruar në kundërshtim me nenet 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KVO në këto rrethana duhet të kishte skualifikuar OE “” dhe ti kishte kërkuar AK anulimin dhe përsëritjen e procedurës së prokurimit në zbatim të neneve 24/ç, 47 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

IV. Për prokurimin publik me objekt “Blerje Kamion Teknologjik mbeturinash FL6-15 dhe Fadromë” kontrata nr ska, datë 10.06.2015 me vlerë 6,465,000 lekë, pa tvsh është konstatuar se jemi përpara një vlerësimi fiktiv nga ana e KVO-së. Kualifikimi i OE “” nga KVO është në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit, pasi OE nuk plotëson

kriteret e vendosura nga AK. KVO duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ka vepruar në kundërshtim me nenet 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KVO në këto rrethana duhet të kishte skualifikuar OE “” dhe ti kishte kërkuar AK anulimin dhe përsëritjen e procedurës së prokurimit në zbatim të neneve 24/ç, 47 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

V. Për prokurimin publik me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë për nevojat të konviktit “KOSOVA” Bashkia Krume-Has”.

Nga OE fitues “” nuk është paraqitur licenca përkatëse për produktet objekt prokurimi dhe dokument që ka në pronësi ose me qira objektin ku ushtron aktivitetin në kundërshtim me DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në pikën 3, “Kapaciteti teknik”, nën pika 2/a,b. Nga Ekstrakti i QKR fusha e veprimtarisë është “Tregti me pakicë artikuj të ndryshëm”.

VI. Për prokurimin publik me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë për nevojat të konviktit “KOSOVA” Bashkia Krume-Has” për vitin 2014

Nga OE fitues “” nuk është paraqitur dokumentin shoqërues nga dega e tatim-taksave që vërteton deklarin dhe realizimin e shitjeve të kontratës të realizuar për vitin 2013 për furnizimin me artikuj ushqimorë Bashkinë Has si dhe nuk është paraqitur licenca përkatëse për produktet objekt prokurimi, në kundërshtim me DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pikën 3, “Kapaciteti teknik”, nën pika 1,4. Nga Ekstrakti i QKR fusha e veprimtarisë është “Tregti me pakicë artikuj të ndryshëm”, të cilën e vërteton dhe vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës i datës 06.05.2014 për shlyerjen e detyrimeve, e cila shprehet se: Tatimpaguesi “D.N.” me objekt veprimtarie “Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim artikujsh ushqimorë”

Pra OE fitues PF “D.N.” nuk i plotëson kriteret e kualifikimit, ky tender duhej të anulohet. KVO ka vazhduar procedurën në kundërshtim me me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” neni 24 “Anullimi i procedurës” pika ç, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu V “Zhvillimi i Procedurave” pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, nën pika (ç)

VII. Për prokurimin publik me objekt: “Blerje Dru Zjarri për nevojat e ngrohjes së objekteve të Bashkisë Has deri me 31.12.2015

Nga KVO nuk është bërë skualifikimi i OE “” shpk, i cili nuk plotëson kriteret e kualifikimit sipas DST në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”.

Miratimi i procedurës dhe fituesit të saj nga AK është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” i cili në pikën 1(ç)

Tre anëtarë të KVO në ish-Komunën Golaj

5. z. Z.B. ish Nën/Kryetar i Komunës Golaj, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

6. zj. R.K. financiere në Komunën Golaj, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

7. z. A.D. ish-teknik ndërtimi në Komunën Golaj, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për shkelje në 2 procedura prokurimi, si më poshtë:

I. Për prokurimin publik me objekt “Rikonstruksioni dhe Asfaltimi Rruga Fshati Vlahën” kontrata nr. 724/1, datë 13.06.2013 me vlerë 67,141,478 lekë, pa tvsh është konstatuar se jemi përpara një vlerësimi fiktiv nga ana e KVO-së. Kualifikimi i BOE “” nga KVO është në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit, pasi BOE nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK. KVO duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ka vepruar në kundërshtim me nenet 46, 53 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KVO në këto rrethana duhet të kishte skualifikuar BOE “” dhe ti kishte kërkuar AK anulimin dhe përsëritjen e procedurës së prokurimit në zbatim të neneve 24/ç, 47 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

II. Për prokurimin publik me objekt “Sistemi i ujrave të zeza për lagjet Kamber, Çunaj, Bardhosh fshati Letaj” kontrata nr. 770, datë 29.06.2013 me vlerë 5,873,443 lekë, pa tvsh është konstatuar se s’kualifikimi i OE “” është i gabuar duke sjellë skualifikim të padrejtë të këtij operatori me ofertë ekonomike më të favorshme se ajo e OE të shpallur fitues. Vlerësimi i KVO-së në përzgjedhjen e ofertës fituese është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreun V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim, **duke sjellë efekt financiar me dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Golaj në vlerën 495,223 lekë.**

D/2-Për Bashkinë Has:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenet 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në proces verbalet nr. 12,14 dhe 15 datë 13.05.2016, komentet e subjektit të audituar.

Duke qenë se Bashkia Has nuk ka krijuar strukturën e IMTV, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj** Bashkisë Has që t’i dërgojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), kopje procesverbaleve dhe vërejtjeve, me qëllim që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë, për 3 mbikëqyrësit** e punimeve **dhe 1 kolaudator** punimesh, **si më poshtë:**

1. Ing. Ll.T. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në 3 objektet si më poshtë:

a- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim i segmentit rrugor Komisariat - Ujësjellës, Krumë”, Bashkia Has, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 996,500 lekë pa tvsh për punime të pakryera, veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

b- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion dhe asfaltim rruga e fshatit Vlahen”, ish-Komuna Golaj, Has, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 4,962,300 lekë pa tvsh për punime të pakryera. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 , “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

c- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Ndërtim i Shkollës 9-Vjeçare Helshan”, ish-Komuna Golaj, Has, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore më tepër në vlerë, në vlerën 1,420,131 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 957,031 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 463,100 lekë si pasojë e përfshirjes në situacionin përfundimtar edhe të vlerës së tvsh të pajisjeve, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

2. ing. L.P. në cilësinë e kolaudatores së punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me “Sistemim Asfaltim i segmentit rrugor Komisariat- Ujësjellës, Krume”, Bashkia Has, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **996,500 lekë** pa tvsh për punime të pakryera. Veprime këto në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, kreu II, pika 3.

3. ing. K.S. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me “Rikonstruksion dhe asfaltim rruga e fshatit Vlahen”, ish-Komuna Golaj, Has, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **4,962,300 lekë pa tvsh** për punime të pakryera. Veprime këto në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, kreu II, Pika 3.

4. ing. H.K. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me “Ndërtim i Shkollës 9-Vjeçare Helshan”, ish-Komuna Golaj, Has, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,420,131 lekë pa tvsh** duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 957,031 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 463,100 lekë, si pasojë e përfshirjes në situacionin përfundimtar edhe vlerën e të tvsh-së për pajisjet. Në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

e. 1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17 të ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar.

e. 2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar.

Shënim: Për 20 punonjësit e mëposhtëm. nuk rekomandohet masë disiplinore pasi kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Has dhe nuk kanë adresim institucional.

1. z. Y.L. me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve (i larguar)
2. z. E.P. me detyrë ish-P/sektorit juridik (i larguar)
3. z. I.M. me detyrë ish-Inspektor i Urbanistikës (i larguar)
4. z. E.C. me detyrë ish-Përgjegjës e Sektorit Juridik (i larguar)
5. z. A.L. me detyrë ish-Inspektor Taksash,(larguar)
6. zj. Xh.B. me detyrë ish-inspektore-arkëtare (larguar)
7. z. B.Sh. në funksionin e ish-Kryetarit të Komunës Fajzë, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (i larguar)
8. z. H.F.me detyrë ish-zv/Kryetar (për periudhën 01.01.2013- 30.03.2014),
9. z. D.Ç. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Taksave (i larguar),
10. z. A.C. me detyrë ish-Inspektor i Financës arshivist dhe në cilësinë e specialistit të magazinë (për periudhën 01.01.2013-18.02.2015) dhe ish-Përgjegjës i Sektorit te Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues (për periudhën 18.02.2015-30.07.2015) (i larguar)
11. z. S.M. me detyrë ish-Përgjegjës i kadastrës në cilësinë e anëtarit të KPVV (për periudhën 18.02.2015-30.06.2015), i larguar
12. z. S.B. me detyrë Përgjegjës e Ndhmës Ekonomike (për periudhën 01.01.2013-30.08.2015), i larguar
13. z. P.Th. në funksionin e ish-Kryetarit të Komunës Gjinaj, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (për periudhën 01.01.2013-30.06.2015), i larguar.
14. z. F.S. me detyrë ish-Sekretar Këshilli (për periudhën 01.01.2013-30.06.2015), i larguar'.

15. z. M.Th. me detyrë ish-Inspektor i Tatim Taksave (për periudhën 01.01.2013-30.04.2015), i larguar.
16. z. A.C. me detyrë ish përgjegjës të financës në ish Komunën Fajzë për periudhën 18.02.2015-07.07.2015,
17. z. A.D. Inspektor tregu, për periudhën 17 mujore, 2011 deri 30.05.2011, aktualisht i papunë.
18. z. E.Q. inspektor tregu për periudhën shtator 2015 deri 31.12.2015
19. znj. N.D. ish juriste e Komunës Golaj, aktualisht jashtë vendit
20. z. Z.K. ish-kryetar i Komunës Golaj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R